



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2021:237133  
Datë: 22.11.2021  
Numri i dokumentit: 02425094

P.nr.3029/21

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Eroll Gashi, me zyrtaren ligjore Merita Mazreku, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.LI, nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Dhunë në familje nga neni 248 par.3 nënpar.3.1 dhe 3.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.487/21F, të dt.22.10.2021, në shqyrtimin fillestar, publik, të mbajtur me dt.16.11.2021, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, prokurorit të shtetit Shenaj Berisha, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av.-Enver Maxhuni, nga Prishtina, i caktuar sipas detyrës zyrtare, më dt.19.11.2021, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më dt.22 Nëntor 2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari:

**F.LI**, nga i ati E. dhe e ëma R., e gjinisë Buzaku, i lindur më 28.08.1990, në Vushtrri, tani me vendbanim në Rr."R.B.", në Fushë Kosovë, me nr. personal ....., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i R. Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse:

Më dt.21.10.2021, rreth orës 09:00, në shtëpinë e tyre në rr. "H. H.", në Fushë Kosovë, i pandehuri F.LI, me dashje, në vazhdimësi ka shkaktuar dhunë në familje me elemente të

dhunës psikologjike, fizike e ekonomike duke i kanosur familjarët me fjalë “ka me ju pre me thikë prej gojës deri tek barku” dhe “nuk ju kamë rrahur mirë”, ndërsa ditën kritike e ka sulmuar fizikisht nënën e tij, të dëmtuarën R.LI, në atë mënyrë që gjersa ishin në shtëpi, e dëmtuara R., ja ka bërë një kafe të pandehurit i cili ka filluar të bërtasë duke thënë “pse është kjo kafja e jeme”, dhe me pas është ngritur nga krevati dhe ka filluar ta godas të dëmtuarën më shumë se 10 herë me boksa në pjesët e kokës dhe kur e dëmtuara ka ikur duke dalë në rrugë, i njëjti e ka nxënë dhe ka filluar ta godas edhe disa herë si dhe i ka thyer dy dyer të shtëpisë dhe një tavolinë, ndërsa gjatë arrestimit nga policia, i pandehuri e ka kanosur të dëmtuarën duke i thënë “nëse prapë hy në burg sherri juve kur të dalë ose unë ose motra ime në këtë shtëpi dhe tregoj babës që kur të dalë prej burgut pa ja futë plim në ballë nuk e lo”, -

- me këtë ka kryer veprën penale Dhuna në familje nga neni 248 par.3 nënpar.3.1 dhe 3.2 të KPRK-së

Andaj, gjykata, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 22, 3, 4, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70 dhe 79 të KPRK-së, si dhe nenit 248, 365, 450 dhe të Kodit të Procedurës Penale, të akuzuarit i shqipton:

### **DËNIM KOMULATIV ME BURGIM DHE ME GJOBË**

- Ashtu që të akuzuarit F.LI, i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, si dhe dënimi me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind Euro), të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.
- Nëse i akuzuari refuzon që të paguajnë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të akuzuarin mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimin me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimin me gjobë do të caktohet nga 1 (një) ditë burgim.
- Të akuzuarit me aktvendim të veçantë i vazhdohet paraburgimi deri në plotfuqishmëri të këtij aktgjykimi.
- Në dënimin e shqiptuar me burgim të akuzuarit, do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.21.10.2021, e deri në plotfuqishmëri të këtij aktgjykimi, në atë mënyrë që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraburgim do të barazohet me 1 (një) ditë burgim.

- Detyrohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumë prej 30 euro, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

## **A r s y e t i m**

### 1. Ecuria e procedurës penale:

1.1 Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, më dt.22.10.2021, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.487/2021F, ndaj të akzuarit F.LI, për shkak të veprës penale Dhunë në familje nga neni 248 par.3 nënpar.3.1 dhe 3.2 të KPRK-së.

1.2.Kompetenca territoriale - Gjyqtari ka vlerësuar se Gjykata Themelore në Prishtinë, duke u bazuar në nenin 29 paragrafi 1 të KPPRK-së, ka kompetencë territoriale për ta gjykuar këtë çështje, për arsye se vepra penale është kryer në Fushë Kosovës, që bie në kompetencë territoriale të kësaj Gjykate.

1.3.Kompetenca lëndore - Duke u bazuar në nenin 20 të Ligjit për Gjykatat, Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore, është kompetentë për ta gjykuar një çështje, ku për atë vepër penale parashihet dënim me gjobë ose me burgim deri në dhjetë vite, dhe po ashtu kjo vepër penale nuk është përfshirë në nenin 22 të KPPRK-së. Në rastin konkret kemi të bëjmë me veprën penale Dhunë në familje nga neni 248 par.3 nënpar.3.1 dhe 3.2 të KPRK-së, e dënueshme me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet dhe e njëjta bije në kompetencë në këtë departament.

1.2 Me dt.16.11.2021, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar lidhur me këtë çështje juridike -penale, në të cilën prezantuan përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, prokurori i shtetit Shenaj Berisha, i akuzuari F.LI si dhe mbrojtësi i tij av.-Enver Maxhuni, sipas detyrës zyrtare, ku edhe është njoftuar i akuzuari me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 të KPPK-së. .

1.3 Pas leximit të akuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohem, duke shtuar se: jam penduar thellësisht për këtë vepër penale i kërkoi falje Nënës time , i premtoi se më asnjëherë nuk do të kryej vepër penale asnjëherë më parë nuk ka ndodhur një gjë e tillë, kjo ka qenë hera e parë, andaj i premtoi Gjykatës se asnjëherë më nuk do të kryej vepër penale, unë kam për qëllim që të punësohem të kemë një jetë të rehatshme dhe i propozoi Gjykatës , që paraprakishtë ta

ma nderprej masën e paraburgimit të më mundësohet që të vazhdoi me jetën time , dhe familjen time nuk do ta pengoi , pasi që unë edhe jetoj vetë dhe Gjykata të më shqiptoi një dënim sa më të butë si dënimi me kusht.

1.4 Mbrojtësi i të pandehurit av.-Enver Maxhuni, lidhur me fajësinë deklaroi se e mbështes ne tersi pranimin e fajësisë nga i mbrojturi im dhe i cili pranim është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mua si mbrojtës. Duke marrë parasysh të gjitha faktet rrethanat që i përmendi i akuzuari, i propozoi Gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të mbrojturit tim si rrethane lehtësuese ta ketë parasysh pranimin e fajësisë si rrethanë lehtësuese pendimin e thelle që e paraqet i akuzuari dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të bjerë ndesh me ligjin e po ashtu edhe premtimin se i njëjti nuk do të bezdis familjen e tij me dhe do të filloi një jete të re ndaras nga familja vetëm e vetëm që mos të ketë me probleme por nejeherit sa të ketë nevoja të ju dal ne ndihme prindërve të tij. Meqenëse kanë pushuar kushtet për vazhdimin për masën e paraburgimit i propozoi Gjykatës që në këtë seance të ja ndërpris masën e paraburgimit ndaj të mbrojturit tim.

1.5 Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e pafajësisë, se pranimi i fajësisë është në përputhje me dispozitat ligjore si dhe provat që ia kemi bashkangjitur aktakuzës, po ashtu gjatë matjes së dënimit të ketë parasysh se i njëjti është përsëritës i veprave penale të Dhunës në Familje.

1.6 E dëmtuara R.LI, deklaroi se sa i përket meje bashkëshortit tim dhe vajzës tonë ky ka respekt të madh, ka pasur probleme shëndetësore me herët ne si prindër jemi munduar maksimalisht vetëm që ky të bëhet mirë, është e vërtetë që ky asnjëherë nuk ka bërë probleme jashtë shtëpisë, mirëpo brenda në familje ka sjellje tjera, i pengon çdo gjë, mirëpo ne si familje konkretisht prindërit e tij të shtyrë në moshë jemi në gjendje që të bëjmë çdo gjë vetëm që Fisniku të përparojë, nga ana e jonë kërkojmë që vetëm ky të përmirësohet, ne si prind nuk kërkojmë që të dënohet ti jepet edhe njëherë mundësia sepse siç thashë edhe me herët, qëllimi ynë edhe dëshira që ky të të përparojë, edhe pse jam në moshë jam e operuar e po ashtu edhe babi i tij është i sëmurë prej zemrës por ne prapë do të mundohem që të jemi afër tij, nuk kërkojmë kurrfarë dëmshpërblimi nga ana e tij, por vetëm që ky të përparojë.

## 2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë:

2.1 Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari F.LI, për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par.1 të KPPK-së. Në këtë aspekt, gjykata, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me

benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar:

3.1 Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari i vetme gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akzuar F.LI, me dashje e ka kryer veprën penale: Dhuna në familje nga neni 248 par.3 nënpar.3.1 dhe 3.2 të KPRK-së, në datën, kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin të këtij aktgjykimi dhe për të njëjtën është përgjegjës.

### 4. Elementet e veprës penale:

4.1 Në par.1. të nenit 327 të KPRK-së, është përcaktuar se, forma themelore e veprës penale Dhuna në familje, sipas së cilës dispozitë, është paraparë se këtë veprë penale e kryen: “Kushdo që e kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në 3 (tre) vjet”. Ndërsa par.3 i të njëjtit nenë, është paraparë forma e kualifikuar e kësaj veprë penale, sipas së cilës dispozitë, parashihet se: “Çdo anëtar i familjes që ushtron dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik ndaj anëtarit tjetër të familjes së tij/saj, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet”, dhe sipas nënpar.3.1 është paraparë . “Marrëdhënia familjare” për nevojat e kësaj dispozite është në përputhshmëri me përkufizimin në nenin 113 të këtij kodi. Ndërsa sipas nënpar.3.2 parashihet se “Dhuna në familje, dhuna fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, për nevojat e këtij kodi do të jetë e njëjtë siç është përkufizuar në dispozitën e nenit 2, nën paragrafi 1.2. të Ligjit nr. 03/L-182 për mbrojtje nga Dhuna në Familje”.

4.2 Prandaj, nga dispozitat e lartcekura rezultojnë se, në veprimet e të akzuarit janë përmbushur elementet e veprës penale Dhuna në familje nga neni 248 par.3 nënpar.3.1 dhe 3.2 të KPRK-së, pasi që, siç e ka pranuar edhe vetë i akzuar në shqyrtimin fillestar, i njëjti me dashje, në vazhdimësi ka shkaktuar dhunë në familje me elemente të dhunës psikologjike, fizike e ekonomike duke i kanosur familjarët me fjalë “ka me ju pre me thikë prej gojës deri tek barku” dhe “nuk ju kamë rrahur mirë”, ndërsa ditën kritike e ka sulmuar fizikisht nënën e tij, të dëmtuarën R.LI, në atë mënyrë që gjersa ishin në shtëpi, e dëmtuara R., ja ka bërë një kafe të pandehurit i cili ka filluar të bërtasë duke thënë “pse është kjo kafja e jeme”, dhe me pas është ngritur nga krevati dhe ka filluar ta godas të dëmtuarën më shumë se 10 herë me boksa në pjesët e kokës dhe kur e dëmtuara ka ikur duke dalë në rrugë, i njëjti e ka nxënë dhe ka filluar ta godas edhe disa herë si dhe i ka thyer dy dyer të shtëpisë dhe një tavolinë, ndërsa gjatë arrestimit nga policia, i pandehuri e ka kanosur të

dëmtuarën duke i thënë “nëse prapë hy në burg sherri juve kur të dalë ose unë ose motra ime në këtë shtëpi dhe tregoj babës që kur të dalë prej burgut pa ja futë plim në ballë nuk e lo”.

#### 5. Vendimi për shpalljen fajtor:

5.1 Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata ka vendosur ta shpallë fajtor të akuzuarin F.LI, për shkak të veprës penale *Dhuna në familje nga neni 248 par.3 nënpar.3.1 dhe 3.2 të KPRK-së*, ngase, në veprimet e të njëjtit konsumohen të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se siç e ka pranuar edhe vetë, i njëjti në ditën kritike për të cilën edhe akuzohet ka ndërmarrë të gjitha veprimet e cekura në aktakuzë.

#### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

6.1 Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit F.LI, Gjykata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPRK-së.

6.2 Në këtë aspekt, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lartë, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, e që kjo është një rrethanë e cila duke i ndërlidhur me rrethanat tjera, si fakti se i njëjti është penduar thellë dhe i ka kërkuar falje të dëmtuarës, se kjo ka qenë hera e parë si dhe premtimin e tij ndaj Gjykatës se asnjëherë më nuk do të ndodh që të bëjë sjellje të tilla, janë rrethana të cilat tregojnë se edhe me dënimin e shqiptuar si në dispozitivë të këtij aktgjykimi, mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe se i akuzuari me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale.

6.3 Ndërsa, gjykata si rrethanë rënduese për të akuzuarin ka gjetur: shkallën e lartë të dashjes nga ana e të akuzuarit, që të ushtroj dhunë ndaj anëtarëve të familjes së tij, posaçërisht ndaj nënës së tij, duke cenuar rënd nderin dhe autoritetin e sajë, një ndër vlerat më të larta të njeriut, e që Gjykata, me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe do të ndikojë në riedukimin dhe risocializimin e tij.

#### 7. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar:

7.1 Sipas bindjes së Gjykatës, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve si dhe dënimi me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro, duke i marrë për bazë rrethanat e

përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit.

7.2 Gjykata, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, (duke e bërë të vetëdijshëm për natyrën dhe shkallën e dënimeve për veprat penale që mund të kryej në të ardhmen, por edhe për mundësin që të kthehet në një element kontribuues për vete, familjen dhe për rrethin ku ai jeton), të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 8. Zëvendësimi i dënimit me gjobë:

8.1 Duke u bazuar në nenin 46 të KPRK, gjyqtari i vetëm gjykues ka vendosur që nëse i akuzuarit refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë, dënimi me gjobë me pajtimin e të akuzuarit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë, dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzetë Euro) të dënimit me gjobë do të caktohet nga 1 (një) ditë burgim.

#### 9. Vendimi lidhur me masën e paraburgimit:

9.1 Gjykatësi i vetëm gjykues, duke e bazuar në nenin 367 paragrafi 3 lidhur me par.1 pika 1.1 e lidhur me par.7 të KPP-së të KPPRK-së, me aktvendim të veçantë, ndaj të akuzuarit F.LI, pas shpalljes së aktgjyimit, ka vazhduar masën e paraburgimit, nga data e shpalljes së aktgjyimit e deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi por jo më shumë se dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.

9.2 Ndërsa, duke u bazuar në nenin 79 të KPRK, në dënimin e shqiptuar me burgim të akuzuarit, do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.21.10.2021, e deri në plotfuqishmëri të këtij aktgjykimi, në atë mënyrë që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraburgim do të barazohet me 1 (një) ditë burgim.

#### 10. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale:

10.1 Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues, duke u bazuar në nenin 451 par.1 të KPP-së, është detyruar i akuzuari konform dispozitave ligjore të nenit 450 të KPP-së, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas listës së shpenzimeve përfundimtare, në emër të fondit për kompensimin e viktimave shumë prej 30 euro dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë

prej 30 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

10.2 Vendimin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, u morë në bazë të Ligjit nr.05/L-036.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 248 dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.3029/21, më dt.22 Nëntor 2021.**

**Zyrtarja Ligjore**  
**Merita Mazreku**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Eroll Gashi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.



Numri i lëndës: 2021:237133  
Datë: 22.11.2021  
Numri i dokumentit: 02425094